

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6583
E mërkurë, 13 prill 2022
çmimi 0.40 €

Reagim i KMDLNj-së
**Mashtrimi i radhës i
mashtruesit Dik Marti!**

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA DEBATUAR TË MARTËN PËR POLITIKËN E JASHTME | FAQE 4-5

OPOZITA: ME QEVERINË KURTI KA DEGRADIM TË POLITIKËS SË JASHTME



Partitë opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Albin Kurti dhe ministrin e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla, sa i

përket politikës së jashtme. Në debatin parlamentar për këtë temë, opozita ka theksuar se me qeverinë Kurti ka degradim të

politikës së jashtme. Partitë opozitare kanë bërë thirrje për ripozicionim të Kosovës në politikën e jashtme

**Konjufca: Kosova
aspiron anëtarësimin
në BE dhe NATO** | FAQE 3



**PROKURORIA: EKSPERTIZA
ZVICERANE NUK GJEN ADN TJETËR
PËRVEÇSE TË DEHARIT**

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@ml.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



**UKRAINA PO HETON RAPORTIMET
PËR SULM ME ARMË KIMIKE** F. 2

**PSD-JA IA DORËZON NAGAVCIT
LETRËN E DORËHEQJES** F. 3

**TË RINJTË NË FOKUS TË TAKIMIT
NË MES TË KRYETARËVE TË
MITROVICËS DHE TË TIRANËS** F. 6

EKONOMI



**PAKOJA E RE EKONOMIKE: NGA 100
EURO PËR PUNËTORËT E SEKTORIT
PRIVAT DHE PUBLIK, STUDENTËT
DHE PENSIONISTËT** F. 8

SPORT



**SOT MËSOHEN FINALISTËT
E KUPËS** F. 10

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Boris Johnsoni do të gjobitet për ndejat gjatë izolimit



LONDËR, 12 PRILL - Kryeministri britanik Boris Johnson dhe kancelari Rishi Sunak do të gjobiten nga policia për pjesëmarrjen e tyre në ndejat të organizuara gjatë izolimit. Zyra e Johnsonit ka konfirmuar se dy zyrtarët janë njoftuar nga policia se do t'i pranojnë dënimet e tyre me gjobë. Lideri i laburistëve, Keir Starmer, ka bërë thirrje që dypolitikantët të japin dorëheqje. Policia kishte hetuar organizimin e 12 ndejave të mbajtura nga zyra e Johnsonit në kohën kur në

Mbretërinë e Bashkuar kishte masa kundër koronavirusit. Lidhur me këtë rast deri më tani janë shqiptuar 50 gjoba. Policia ka thënë se nuk do t'i bëjë publike emrat e të gjithë personave të gjobitur, por qeveria kishte premtuar se do të njoftojë nëse Johnsoni dhe Sunak ishin në mesin e të gjobiturve. Një zëdhënës i Johnsonit tha se ende nuk janë njoftuar se për cilën ngjarje janë gjobat. Por, Keir ka thënë se këto ngjarje dëshmojnë se Johnsoni dhe

Sunak nuk janë të përshtatshëm për të qeverisur, duke shtuar se "Britania meriton më mirë". "Boris Johnsoni dhe Rishi Sunak kanë shkelur të gjitha ligjet dhe vazhdimisht e kanë gënjyer publikun britanik. Që të dy duhet të japin dorëheqje", tha ai. Lideri i liberaldemokratëve, Ed Davey, bëri thirrje që Parlamenti - që aktualisht është në pushimin e Pashkëve - të mbledhet dhe të mbajë një mocion mosbesimi ndaj kryeministrit. "Kjo qeveri në krizë po neglizhon një vend në krizë", tha ai.

Ukraina po heton raportimet për sulm me armë kimike

KIEV, 12 PRILL - Ukraina ka thënë se është duke analizuar raportimet se Rusia mund të ketë përdorur armë kimike në kohën e luftimeve të ashpra në qytetin e Mariupolit. Mbretëria e Bashkuar ka paralajmëruar se Rusia do të "përgjigjet" nëse informacioni për armët kimike rezultojnë të jetë i vërtetë.

Rusia ka hedhur poshtë akuzat, të cilat vijnë pas paralajmërimeve serioze nga shtetet e Perëndimit për përdorim potencial të armëve kimike apo atyre bërthamore në luftën në Ukrainë.

Zëvendësministrja e Mbrojtjes në Ukrainë, Hanna Malyar, ka thënë se autoritetet ushtarake janë duke hetuar pretendimet në Mariupol se një numër i paspecifikuar i njerëzve janë përballur me probleme të frymëmarrjes dhe ato neurologjike, pas një sulmi me dron. "Ka teori se këto mund të jenë municione me fosfor", ka thënë Malyar në një intervistë televizive më 12 prill. "Informacioni zyrtar do të pasojë më vonë".

Fosfori nuk konsiderohet armë kimike, mirëpo armë ndezëse e cila shkakton djegie të rënda. Nuk është ilegale që ushtritë të përdorin fosfor, ndonëse shënjestrimi i civilëve me çfarëdo

arme ndalohej me Konventën e Gjenevës.

Agjencia e lajmeve "Interfax" ka raportuar më 12 prill se forcat separatiste pro-ruse në rajon po ashtu kanë mohuar përdorimin e armëve kimike.

Komentet e Malyarit kanë ardhur një ditë pasi presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka bërë një paralajmërim se zyrtarët janë duke e trajtuar "me shumë seriozitet" shqetësimin se Rusia mund të përdorë armë kimike.

Zëdhënësi i Pentagonit, John Kirby, ka thënë më 11 prill se Uashingtoni është në dijeni për raportimet, mirëpo nuk mund t'i konfirmojë ato.

Qyteti i Mariupolit është tejet i rëndësishëm për Rusinë, pasi kontrollimi i tij do të mund të lidhte zonat e kontrolluara nga separatistët e mbështetur nga Moskë në lindje të Ukrainës bashkë me Krimenë, të cilën Rusia e ka aneksuar nga Ukraina më 2014.

Mbi katër milionë fëmijë ukrainas kanë braktisur shtëpitë

Gati dy të tretat e fëmijëve ukrainas kanë ikur nga shtëpitë e tyre prej nisjes së pushtimit rus



në Ukrainë gjashtë javë më parë, ka njoftuar Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) më 12 prill.

Kombet e Bashkuara kanë verifikuar vdekjen e 142 të rinjve, ndonëse kanë paralajmëruar se shifrat e sakta mund të jenë shumë më të larta. Manuel Fontaine, drejtor i

Programit për Emergjencë në UNICEF, i cili sapo është kthyer nga Ukraina, ka thënë se largimi i 4.8 milionë fëmijëve ukrainas nga shtëpitë e tyre në një kohë kaq të shkurtër është diçka që ai nuk e ka parë në 31 vjetët e tij në punën humanitare.

"Nga 3.2 milionë fëmijë që vlerësohet se kanë mbetur në

shtëpitë e tyre, gati gjysma e tyre mund të mos kenë mjaftueshëm ushqim", ka thënë Fontaine për Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Ai ka paralajmëruar se situata është e rëndë në qytetet Mariupol dhe Herson, ku nuk ka as ujë, dhe furnizimet me ushqim dhe ilaçe janë penguar.

Gjermania, pas armatosjes së Serbisë nga Kina: Përafroji politikën me BE-në



BERLIN, 12 PRILL - Gjermania ka njoftuar më 12 prill se ka parë raportimet se Serbia ka pranuar raketa kundërajrore ruse, duke paralajmëruar se ky shtet i Ballkanit duhet ta përafrojë politikën e tij të jashtme me të Bashkimit Evropian, nëse dëshiron të bëhet anëtar i bllokut. Mediet kanë raportuar se avionët transportues të ushtrisë kineze javën e kaluar kanë transportuar në Beograd sistemin e mbrojtjes tokë-ajër FK-3, sistem që

është i ngjashëm me sistemin rus S-300, apo atë amerikan Patriot.

Autoritetet në Serbi ende nuk kanë konfirmuar se kanë pranuar dërgesën me këto sisteme.

Beogradi ka paguar për raketat FK-3 dhe për dronët luftarakë kinezë CH-92A më 2019, duke e bërë Serbinë operatoren e parë të këtyre armëve kineze në Evropë. "Si një çështje parimore, pritjet e qeverisë federale për të gjithë kandidatët që aspirojnë t'i

bashkohen BE-së është se ata i bashkohen politikës përbashkët të jashtme të BE-së dhe politikës së sigurisë dhe në këtë mënyrë t'i afrohen gjithnjë e më shumë BE-së", tha zyra për media e Federatës së Gjermanisë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, duke folur në fundjavë gjatë stërvitjeve ushtarake, pranoi se ai planifikon që ta prezantojë "krenarinë e re" të ushtrisë së tij gjatë kësaj jave, por nuk dha më shumë detaje.

Kosova inauguron Këshillin për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut

PRISHTINË, 12 PRILL (ER) - Republika e Kosovës ka inauguruar Këshillin për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut. Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thënë se ky është një mekanizëm përgjegjës për koordinimin dhe garantimin e mbarëvajtjes së

punës së të gjitha institucioneve, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për përmbushjen e zotimeve të prezantuara në Samitin për Demokraci. "Përkushtimi i institucioneve tona kyçe në këtë drejtim, përfshirë shoqërinë civile, është dëshmi e

seriozitetit të Republikës së Kosovës në përmbushjen e zotimeve të dhëna në këtë samit të presidentit Joe Biden, e që ndërlidhen me luftimin e korrupsionit, mbrojtjen nga autoritarizmi dhe avancimin e të drejtave të njeriut", ka theksuar presidentja Osmani.



PSD-ja ia dorëzon Nagavcit letrën e dorëheqjes

PRISHTINË, 12 PRILL (ER) - Partia Socialdemokrate (PSD) ia ka dorëzuar të martën Arbërie Nagavci letrën e dorëheqjes nga pozita e ministres së Arsimit. Nënkrjetari i PSD-së, Qëndron Kastrati, ka thënë se sot ministres Nagavci ia dorëzuaam letrën e dorëheqjes së cilës i mungon veç

nënshkrimi i saj. "Në përvjetorin e Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që ka shkelur tri prej dokumenteve kyçe që ruajnë demokracinë në Kosovë; Kushtetutën, Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Veprimi i

saj ndërhyrës ka shtrembëruar vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe ka dëmtuar potencialin jashtëzakonisht të dobishëm të reformës në arsim. Për veprimet e saj, ministrja Nagavci duhet të japë dorëheqje të menjëhershme", ka deklaruar Kastrati.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka hedhur poshtë vendimin e Ministrisë së Arsimit për organizimin e mësimin alternativ të përshpejtuar dhe përcaktimit të organizimit të mësimin në objektet shkollore në komunën e Kamenicës. Gjykata ka theksuar se MASHTI-i përmes vendimit

"ka tejkaluar kompetencën dhe ka cenuar përgjegjësitë komunale, përkatësisht ka ndërhyrë në kompetencat vetjake të komunës së Kamenicës përkitazi me ofrimin e arsimit publik, në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe ligjore".



Konjufca: Kosova aspirojnë anëtarësimin në BE dhe NATO



PRISHTINË, 12 PRILL (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se Kosova ka dy aspirata, anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe atë në NATO. "Përcaktimi ynë është shumë i qartë. Sot demokracitë më të fuqishme të botës janë të organizuara në dy institucione shumë të rëndësishme që ne i

aspirojmë, në Bashkimin Evropian, ku e kemi rrugën e qartë, rrugën e transformimit, si dhe në aleancën më të fuqishme ushtarake, NATO-n, ku synojmë të anëtarësohemi sa më shpejt", ka thënë Konjufca të martën. Sipas tij, demokracia nuk mund të qëndrojë vetë, por nevojiten aleanca me demokracitë e tjera.

"Siç po e shohim edhe prej ngjarjeve të fundit në botë dhe invazionit të Rusisë mbi Ukrainën, demokracia nuk mund të qëndrojë vetë, por nevojiten aleanca me demokracitë e tjera, për sa kohë edhe në botë po shohim se autokratët janë më të lidhur se kurrë me njëri-tjetrin", ka deklaruar Konjufca.

504 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 12 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 536 testeve, nëntë qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të martën janë shënuar 39 qytetarë, ndërsa

numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 123. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 504. Në 24 orët e fundit janë dhënë 90 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 882 780 doza të vaksinës. Deri më sot 821 117 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 100 625 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.





KUVENDI I KOSOVËS KA DEBATUAR TË MARTËN PËR POLITIKËN E JASHTME

Opozita: Me qeverinë Kurti ka degradim të politikës së jashtme

Partitë opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Albin Kurti dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla, sa i përket politikës së jashtme. Në debatin parlamentar për këtë temë, opozita ka theksuar se me qeverinë Kurti ka degradim të politikës së jashtme. Partitë opozitare kanë bërë thirrje për ripozicionim të Kosovës në politikën e jashtme

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 PRILL - Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të martën debat parlamentar në lidhje me politikën e jashtme. Ky debat parlamentar është thirrur nga grupi parlamentar i PDK-së.

Kryetari i kësaj partie, Memli Krasniqi, gjatë fjalës së tij në Kuvend ka thënë se politika e jashtme e Kosovës është pezulluar tërësisht. Ai ka thënë se përkundër se sot po zhvillohet një momentum i veçantë gjeopolitik, qeveria nuk e ka as si ide, as si veprim e as si angazhim atë lloj politike të jashtme që ka për fokus Kosovën dhe pozicionimin dhe avancimin e saj në skenën ndërkombëtare. Sipas Krasniqit, për njohje të reja dhe anëtarësime në organizata ndërkombëtare as nuk mund të flitet. "Kjo na bëhet e qartë në disa dimensione, që nga rrafshi i përfaqësimit diplomatik, te mungesa e një agjende politike në

planin ndërkombëtar, e deri te reduktimi i politikës së jashtme në turizëm politik pa relevancë. Që nga themelimi i Shërbimit Diplomatik të Kosovës e deri në ardhjen e këtij pushteti të qeverisë Kurti nuk ka pasur dobësim dhe degradim më të madh të këtij shërbimi", ka thënë Krasniqi.

Ai ka përmendur edhe shkarkimin e pamenduar të ambasadorëve të Kosovës në qendrat kryesore botërore, pa u zëvendësuar me të tjerë gjë që, sipas tij, ka prodhuar jo vetëm vakum të menjëhershëm të pranisë së Kosovës në këto qendra, por edhe ka rritur mosbesimin te shtetet mikpritëse, duke shkundur bashkëpunimin bilateral me këto vende. "E gjithë kjo mësymje, ky vakum, po tentohet të plotësohet nga një ministere e papërvojë dhe jokompetente, e cila prodhon më shumë skandale humoristike sesa paraqitje në skenën ndërkombëtare", ka thënë lideri i PDK-së.

Më tej, në fjalimin e tij, Krasniqi ka

thënë se mendësia qeverisëse e presidentes dhe Listës Guxo e ka kthyer presidenten në ministre të Punëve të Jashtme e ministren Gërvalla në stenografe të mbipaguar nga taksat e qytetarëve të Kosovës.

Duke folur për dialogun Kosovë - Serbi, Krasniqi ka thënë se tani aty nuk po flitet më për njohje të ndërsjellë, por për stikera të targave. Duke e cilësuar situatën si të mjerë në politikën tonë të jashtme dhe për keqardhje, Krasniqi ka thënë se Kosova nuk bën të përfaqësohet në mënyrë të përgjegjshme dhe amatore sepse po i prishë raportet me aleatët tanë kryesorë.

Kryetari i PDK-së ka thënë se ky debat parlamentar ka qenë më se i domosdoshëm dhe emergjent sepse përfshin interesin e shtetit tonë në marrëdhënie ndërkombëtare.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se Kosova nuk ka politikë të jashtme efektive, ndërsa shkarkimin e ambasadorëve e ka quajtur hakmarrje të pastër politike. Ai ka thënë se ka mjaftuar një vit i qeverisjes Kurti që Kosova të s'potohet nga harta e investimeve strategjike. "Politika e jashtme nuk bëhet me ligjëratat e forume në organizata", ka thënë Hoti, duke shtuar se kjo bëhet duke

i ruajtur miqësitë, duke i harmonizuar qëndrimet e duke i ndjekur këshillat e partnerëve strategjikë.

Deputeti i LDK-së ka theksuar se Kosova nuk ka pasur asnjëherë politikë të jashtme më të dobët. Hoti më tej ka folur për marrëdhëniet me ShBA-në, duke thënë se nuk janë në nivelin që duhet të jenë.

Kurse kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, gjatë fjalës së tij në Kuvend, ka thënë se qeveria Kurti po e lufton UÇK-në dhe po i kundërshton Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Vlera e jashtme është NATO-ja e prirë nga Amerika. Kushdo që udhëheq Kosovën s'guxon të dalë prej themeleve të veta. Në kohën sa LV-ja ka qenë në opozitë i ka menduar si fajtorë të gjithë të tjerët dhe ia ka lënë fajin UÇK-së se komandantët po e udhëheqin vendin. Në raste të caktuara, ka menduar se ka faj edhe Ibrahim Rugova, po ashtu se Amerika ka faj, se po i mban në pushtet komandantët. Për fat të keq, sot e kësaj dite tri vlera janë të rrënuara. Luftohet UÇK-ja. Po vazhdohet qëndrimi kundër Amerikës, dhe qeveria Kurti është duke harxhuar kreditet e atyre që s'janë më në jetë", ka thënë Haradinaj.

Ish-kryeministri Ramush

Haradinaj ka thënë se po synohet që projektet e Amerikës të mos implementohen. "Projekti i gazsjellësit rezulton me dobësinë e Amerikës për ta hequr gazin rus nga Serbia. Dy faktorë nuk kanë pushtet ekzekutiv në vend, UÇK-ja dhe Amerika. Bëhet çmos në mënyrë konsistente që të mos ndodhin projektet që i synon Amerika deri te marrëveshjet bilaterale", është shprehur Haradinaj.

Ndërkaq ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, gjatë debatit parlamentar për politikën e jashtme, ka thënë se, pas pushtimit të Ukrainës dhe sulmeve të sigurisë dhe paqes globale, Kosova u është bashkuar shteteve demokratike për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave që ndëshkojnë Rusinë në bazë të sanksioneve. "Jo Amelika, Amelika, por kështu tregohet partneriteti strategjik dhe ku qëndron Kosova. Prandaj për mua në këtë takim të sotëm, më vjen keq të dëgjoj nga një ish-ministër i MPJ-së që Republika e Kosovës paska nevojë të ripozicionohet në sferën e politikës së jashtme", ka thënë Gërvalla, duke iu përgjigjur ish-ministrit të Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, i cili ka kërkuar ripozicionim në diplomaci.

Gërvalla ka thënë se Kosova është pozicionuar dhe pozicionimin e ka

Reagim i KMDLNj-së

Mashtrimi i radhës i mashtruesit Dik Marti!

Jorastësisht në këtë kohë "rrodhi" një informatë, se sajuesi i një raportit të rremë, pas së cilës dhunshëm u themelua Gjykata Speciale kundër luftës dhe kundër UÇK-së, Dik Marti, qenka vënë nën mbrojtje të rreptë policore të Zvicrës shkaku se po rrezikohet nga BIA e Serbisë që ka planifikuar ta ekzekutojë përmes vrasësve profesionistë për ta fajësuar pastaj Kosovën dhe shqiptarët për këtë vrasje, si hakmarrje personale ndaj senatorit mashtrues nga Zvicra, ish-zëvendësuesit të përfaqësuesit të Zvicrës në Këshillin e Evropës për tetë vjet dhe pastaj, thuaja aq kohë edhe përfaqësuesit të rregullt të këtij shteti. Realisht, ky raport që ka bartur firmën e Dik Martit ka qenë raport i përfaqësuesit të Rusisë në Këshillin e Evropës, Konstatin Kosachev, e që tani është njeri i besueshëm i Putinit dhe i ranguar në 5-shën më me ndikim në Rusi. Raporti i një mashtruesi si puna e

Dik Martit ka qenë i programuar që të shkaktojë tërmet në opinionin ndërkombëtar sepse si gjetje kryesore ishte trafikimi i qenieve njerëzore dhe nxjerrja e kundërligjshme e organeve të serbëve, romëve dhe shqiptarëve që, si pengje lufte, janë dërguar në territorin e Shqipërisë për t'i dërguar ato organe në shtete të tjera për transplantim. Kjo gjetje monstruoze ka qenë përcaktuese që të formohet Gjykata Speciale dhe në këto rrethana askush në Kosovë nuk ka pasur guxim ta kundërshtojë seriozisht përveçse kanë votuar kundër në ditën e votimit në vitin 2015 në Kuvendin e Kosovës. Atëbotë edhe disa pjesëtarë të "shoqërisë civile" thyenin këmbët në përpjekje që të gjejnë ndonjë organ eventuale të nxjerrë kundërligjshëm në "Shtëpinë e Verdhë", shtëpia e Katuçëve në fshatin Rripe të Shqipërisë, ndonëse një ekip

hetues i UNMIK-ut nuk kishte gjetur asgjë të dyshimtë kur kishte bërë hetime pikërisht në atë fshat dhe për të njëjtin motiv. Pasi u themelua Gjykata Speciale e cila substancialisht e dhunon sistemin e drejtësisë në Kosovë, ndonëse deklarativisht është pjesë e këtij sistemi, akuza për trafikim të qenieve njerëzore dhe trafikim të organeve të nxjerrja kundërligjshëm të serbëve, romëve dhe shqiptarëve që kanë bashkëpunuar me Serbinë, ka rënë krejtësisht dhe nuk përmendet më që e tregon qëllimin e keq dhe manipulativ, për shkaqe materiale apo politike të mashtruesit Dik Marti që, së bashku me Karla del Ponten dhe Hose Pablo Barajabar, me ndihmën substanciale të Rusisë dhe Serbisë, ishin përcaktues për themelimin e kësaj gjykate raciste që në plane afatgjata e dëmton shumë Kosovën, shqiptarët dhe

luftën e UÇK-së.

Dik Marti asnjëherë nuk ka qenë i rrezikuar fizikisht nga shqiptarët, kurse imuniteti e ka mbrojtur dhe e mbron nga një hetim penal për një raport të porositur, të pavërtetë dhe qëllimkeq. Shpërthimi, si bombë mediale e kërcënimit të Dik Martit nga BIA serbe, ka krijuar, gjithashtu, një shpërthim euforik të shqiptarët dhe pritje se tani do të ndryshojnë gjërat e që nuk do të ndodhë aq më parë që roli i ndyrë e Dik Martit ka përfunduar në çastin kur është votuar Gjykata Speciale. Institucionet e Kosovës nuk duhet fare të merren me Dik Martin sepse nuk fitojnë asgjë nga kjo për faktin se duke u marrë me këtë persona skajshmërisht amoralë në planin profesional, vetëm sa e faktorizojnë më shumë.

Deputetët që e kanë votuar nën masa të dhunshme themelimin e Gjykatës Speciale duhet urgjentisht ta thërrasin një

mbledhje të Kuvendit të Kosovës ku do të diskutohej për mandatin e kësaj gjykate dhe keqpërdorimet flagrante në fushën e të drejtave të njeriut që ua bënë të akuzuarve, të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës. Ky është roli dhe mandati kushtetues i deputetëve të Kosovës e jo të merren me një diversion medial siç është kërcënimi për jetë i një mashtruesi, ndoshta edhe bashkëpunëtori të BIA-së, Dik Marti. Gjykata Speciale po keqpërdor të drejtat e të arrestuarve, po ndan drejtësi selektive të motivuar në baza etnike si dhe përgjegjësi ekskluzivisht në baza etnike. Duhet të kërkohet përgjegjësi nga kjo gjykatë apo, nëse nuk i nënshtrohet përgjegjësisë, duhet t'i hiqet cilësimi se është pjesë e sistemit juridik të Kosovës dhe të shndërrohet në një gjykatë krejtësisht ndërkombëtare edhe formalisht shkaku se 100 % edhe është ndërkombëtare. Të drejtat e njeriut funksionojnë sipas parimit të universalitetit e jo të reciprocitetit andaj edhe kjo gjykatë duhet t'i përmbahet këtij parimi duke ndarë dhe siguruar drejtësi për të gjitha viktimat pavarësisht prej përkatësisë etnike sikur edhe duke kërkuar përgjegjësi penale për të gjitha ata që kanë përgjegjësi për krime që janë në përgjegjësi të kësaj gjykate, pa bërë asnjë dallim në baza etnike. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, sidomos ata që e kanë votuar themelimin e kësaj gjykate, kanë përgjegjësi institucionale, shtetërore, njerëzore, morale, ligjore, historike dhe personale të nisin një kërkesë për punën dhe mandatin e kësaj gjykate ndryshe do ta kenë përgjegjësi për dëmet që u janë shkaktuar të arrestuarve, familjeve të tyre dhe Kosovës sepse kanë krijuar një mekanizëm që i amnistion krimet e Serbisë në Kosovë duke mos i ndjekur ato. Krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit duhet të ndiqen dhe gjykohej pa bërë asnjë dallim. Lëreni Dik Martin, këtë kufomë morale dhe merruni me përgjegjësitë reale që i keni duke kërkuar drejtësi për të gjitha viktimat dhe përgjegjësi për të gjithë ata që kanë planifikuar, kanë bërë apo nuk kanë penguar krimet, duke mos bërë asnjë dallim.



shumë të qartë. "Pozicionimi i Kosovës në politikën e jashtme është miqësi e përjetshme me Amerikën, partneritet me NATO-n dhe BE-në. S'ka nevojë për ripozionim. Hoxhaj në prani të kamerave dhe deputetëve na garantoj që jo vetëm s'ka njohje të reja, por as s'do të ketë njohje të reja. Prandaj nuk e di se për çfarë e pati fjalën z. Hoxhaj kur foli. Ai garantoj se s'ka dhe s'do të ketë njohje të reja e as liberalizim, e as BE. Mua më lind pyetja se ku e

merr këtë vendosmëri Hoxhaj që Kosova mos të ketë as njohje, as liberalizim e as anëtarësim në BE. Unë s'dua ta interpretoj në atë formë, por të lë një shije të keqe vendosmëria e Hoxhajit për të na treguar që nuk do të ketë procese në të cilat Kosova do të ketë përparim në çështjet e politikës së jashtme", ka thënë Gërvalla. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se më 22 mars të vitit 2021, kur filluan mandatin qeverisës, politikën e jashtme e

gjetën në gjendje të vështirë. "Nuk pati qasje të barabartë në bashkëpunimet bialterale. Nuk pati përgatitje për aplikim në organizata ndërkombëtare dhe asnjë strategji për shtetet që nuk na kanë njohur. Shërbimi i jashtëm ishte në gjendje të rënduar. Pas një viti kemi situatë rrënjësisht tjetër. Kosova ka përfaqësimit dinjitoz", ka thënë kryeministri Kurti. Rreth orës 16:00, derisa debati vazhdonte, kryeministri Kurti është larguar nga seanca e Kuvendit.

Vetëm pak minuta më pas nga seanca është larguar edhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla. Kjo ka nxitur reagimin e deputetëve opozitarë. Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka theksuar se largimi nga seanca i ministres Gërvalla e bën të pakuptimtë vetë debatit dhe arsyen pse është thirrur debati. Ai ka thënë se deputetët e PDK-së nuk do të vazhdojnë të qëndrojnë

më në seancë. Ngjashëm kanë vepruar edhe deputetët e partive të tjera opozitare, të LDK-së dhe të AAK-së, të cilët e kanë braktisur seancën.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka konstatuar se pas largimit nga seanca të propozuesve të debatit, por edhe të deputetëve të tjerë të partive opozitare, debati nuk mund të vazhdojë. Ai ka theksuar se seanca për këtë temë "do të vazhdojë në një tjetër moment".

Rama: Shumë nga projektet e premtuara i kemi vënë në binarët e duhur

PRISHTINË, 12 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, duke folur për 100 ditët e punës, ka bërë me dije se shumë nga projektet e premtuara gjatë fushatës i ka vënë në binarët e duhur.

“Kaluan tashmë më shumë se njëqind ditë që kur me ekipin tim morëm përgjegjësinë për drejtimin e kryeqytetit, me qëllim që ta jetësojmë vizionin tonë për transformimin e Prishtinës në përputhje me planin,

projektet dhe konceptet që shpalesim vjet gjatë fushatës parazgjedhore. Sot mund të shpallim se shumë nga projektet e premtuara gjatë fushatës i kemi vënë në binarët e duhur”, ka thënë Rama.




Lansohet platforma ‘Ambientalisti.info’

PRISHTINË, 12 PRILL (ER) - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka lansuar platformën Ambientalisti.info. Kjo platformë dhe ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Rritja e aktivizimit qytetar në reformat mjedisore përmes një shoqërie civile aktive” e që mbështetet nga “Programi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën”, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). “Gjatë dekadës së fundit mbrojtja e mjedisit nuk është konsideruar si prioritet në Kosovë. Për më tepër, përfshirja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse për çështjet mjedisore mbetet në ajër. Mungesa e gjithëpërfshirjes në procesin mjedisor është shqetësuese dhe më së shumti si rezultat i hezitimit politik për t’i përfshirë qytetarët në procese kaq të rëndësishme. Për shkak të problemeve të lartpërmendura, Kosova po ballafaqohet me qindra hidrocentrale, gurëthyes, objekte të tjera ilegale, të cilat kanë degraduar rëndë mjedisin dhe kanë

ndryshuar jetën e njerëzve që jetojnë pranë tyre. Po ashtu, Kushtetuta e Kosovës parasheh që përgjegjësia për mbrojtjen e mjedisit është e të gjithëve dhe që qytetarëve t’u garantohej përfshirja në proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë me mjedisin që jetojnë, ndërkohë që obligon institucionet publike që të angazhohen për garantimin e kësaj themelore. Prandaj, me qëllim të informimit të rregullt dhe inkurajimit të përfshirjes qytetare në çështjet lidhur me mjedisin, është krijuar platforma ‘Ambientalisti’, është bërë me dije në njoftimin e GLPS-së.

Kjo platformë vjen e ristrukturuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS). Qëllimi i platformës është që të bëhet një qendër informative për çështjet që kanë të bëjnë me aspektet mjedisore në Kosovë, dhe një vend ku qytetarët dhe komunitetet në mbarë Kosovën mund të informohen rregullisht dhe të inkurajohen për t’u përfshirë. Ambientalisti është i qasshëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Në të njëjtën kohë, ambientalisti mund ta gjeni edhe në rrjetet sociale, më saktësisht në “Facebook”.



Të rinjtë në fokus të takimit në mes të kryetarëve të Mitrovicës dhe Tiranës



TIRANË, 12 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, bashkë me delegacionin nga komuna e Mitrovicës, u prit nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

Hamza, pasi ka falënderuar për mikpritje homologun e tij, ka thënë se ndihet jashtëzakonisht mirë në kryeqytetin i cili, falë punës së Veliajt, është shndërruar në një model edhe për kryeqendrat e mëdha rajonale dhe evropiane.

Në anën tjetër, Veliaj ka shprehur mirënjohjen dhe urimet më të mira për kryetarin Hamza, dhe u shpreh jashtëzakonisht i lumtur që tashmë edhe Mitrovica është pjesë e familjes së madhe të Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon.

Ndër të tjera, është diskutuar për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta për të rinjtë e Tiranës dhe Mitrovicës në fushën e inovacionit, artit, kulturës si dhe rritjen e bashkëpunimit në mes të

organizatave rinore të të dy qyteteve, pasi që Tirana është Kryeqyteti Evropian i Rinisë për vitin 2022, të rinjtë e Mitrovicës do të realizojnë projekte konkrete bashkë me të rinjtë e Tiranës.

Pas shkëmbimit të përvojave dhe ideve, të dy kryetarët u pajtuan për bashkëpunim institucional në fushën e digjitalizimit, inovacionit, ekonomisë, turizmit, administratës dhe arsimit, si dhe në zhvillimin e agroturizimit dhe turizmit rajonal.

EULEX-i i dhuron komunës së Mitrovicës një veturë dhe pajisje teknologjike

MITROVICË, 12 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të martën në takim shefin e EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark. Qëllimi i këtij takimi ishte dorëzim-pranimi i një veture dhe pajisje teknologjike, donacion ky i ardhur nga Misioni i Bashkimit Evropian për

Sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX, për nevojat e komunës së Mitrovicës.

Me këtë rast, kryetari i komunës, Bedri Hamza, ka falënderuar shefin e EULEX-it për vizitën dhe donacionin e ofruar të një veture dhe pajisje teknologjike, duke theksuar se komuna mirëpret bashkëpunimin e misionit

në fusha të ndryshme qoftë në arsim, shëndetësi, digjitalizim apo të tjera.

Në fund të takimit kryetari Hamza dhe shefi i EULEX-it, Wigemark, u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve edhe për projekte të tjera të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve.



Prokuroria: Ekspertiza zvicerane nuk gjen ADN tjetër përveçse të Deharit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHINË, 12 PRILL - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se në raportin e pranuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, më 1 prill të këtij viti për rastin e Astrit Deharit, është thënë se analizat e ADN-së, nga objektet që kanë qenë në kontakt me të ndjerin, nuk kanë treguar profil të ADN-së përveçse të vetë atij. Disa prej objekteve të analizuar kanë qenë brisku i rrojës, stilolapsi i lidhur me një lidhëse këpucësh dhe një pjesë metali.

Astrit Dehari ka vdekur më 5 nëntor të vitit 2016 teksa po mbahej në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, si i dyshuar për sulmin ndaj ndërtesës së Kuvendit, në gusht të vitit 2016.

Autoritetet përgjegjëse në Kosovë fillimisht e kanë cilësuar vdekjen e tij si "vetëvrasje", por familja Dehari ka kërkuar që të bëhet ekspertizë ndërkombëtare për shkak të dyshimeve për këtë konstatim.

"Analizat toksikologjike plotësuese të gjakut periferik të Astrit Deharit kanë treguar praninë e kafeinës dhe mospraninë e etanolit. Sa i përket ekshumimit të trupit të të ndjerit nuk ka rekomandim në ekspertizë dhe e njëjta nuk është rekomanduar që të ri ekzaminohet trupi duke pasur parasysh se sa kohë ka kaluar", është thënë në gjetjet e raportit, ka thënë Prokuroria Speciale më 12 prill.

Dokumenti i dorëzuar më 1 prill të këtij viti është ekspertizë shtesë e kërkuar nga autoritetet e drejtësisë në Kosovë, pasi më 24 tetor të vitit 2019 Prokuroria Themelore në Prizren pati publikuar konkluzionet e ekspertizës së Institutit të

Mjekësisë Ligjore për rastin e Deharit. "Ashtu siç është thënë në ekspertizën tonë, ne kemi dyshime që lidhen me rrethanat e vdekjes së Astrit Deharit. Në fakt, hipoteza e një vetëvrasjeje përmes mjeteve të caktuara nga mjekët ligjorë duket pak e vërtetë dhe intervenimi i një personi të tretë në proces fatal duhet të kihet parasysh", është thënë në konkluzionet e ekspertizës së vitit 2019.

Me këtë konstatim Prokuroria e pati kthyer rastin në hetim, pas përfundimeve të mëparshme se bëhej fjalë për vetëvrasje.

Më 30 tetor të po atij viti kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka marrë vendim që rasti i Astrit Deharit të kalojë nga Prokuroria Themelore në Prizren në juridiksion të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), prandaj edhe janë kërkuar hetime shtesë.

Prokuroria Speciale ka thënë se do ta vazhdojë hetimin e këtij rasti dhe do t'i ndërmarrë të gjitha



veprimet e nevojshme.

Bashkë me Astrit Deharin ishin arrestuar katër aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje: Frashër Krasniqi, Adea Batusha, Atthe Arifi dhe Egzon Haliti (v.j. disa prej

tyre tashmë nuk i përkasin Lëvizjes Vetëvendosje). Ata dyshoheshin për sulmin me mjet shpërthyes në objektin e Kuvendit të Kosovës që kishte ndodhur në mbrëmjen e 4 gushtit

të vitit 2016.

Në shkurt të vitit 2017 familja Dehari vendosi që ekspertizën për këtë rast ta kryejë Qendra Universitare e Mjekësisë Ligjore në Zvicër.

Gashi: Astrit Dehari është vrasë, Prokuroria Speciale po manipulon

Avokati mbrojtës i familjes Dehari, Tomë Gashi, ka reaguar pas publikimit të konstatimeve të ekspertizës zvicerane për rastin e Astrit Deharit. Ai ka thënë se Prokuroria Speciale duhet ta tregojë të vërtetën, pa manipulime.

Gashi ka thënë se të gjeturat shkencore japin vetëm një konkludim që Astrit Dehari është vrasë. "Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ekspertizën e ka marrë para 12 ditëve. Qëllimisht apo rastësisht bën hapa të gabueshëm në rastin e hetimit të vrasjes së Astrit Deharit. Ajo ka publikuar një

komunikatë për medie me komente të veta para se t'ju dërgoj kopje të ekspertizës shtesë të Institutit Zviceran, fillimisht familjes së Astrit Deharit si dhe mua si përfaqësues ligjor i familjes Dehari. Prokuroria për të mos e manipuluar opinionin do të duhet fillimisht të tregojë se a ka marrë gjurmë të ADN-së nga të burgosurit që kanë qenë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 05.11.2016. A kanë marrë gjurmë të ADN-së nga i gjithë stafi i Qendrës së Paraburgimit në Prizren. A kanë marrë gjurmë të ADN-së nga gardianët dhe policët të cilët

Astrit Deharin e kanë nxjerrë të gjallë - me shenja jete e nga Qendra e Paraburgimit në Prizren dhe të vdekur - pa shenja jete e kanë dërguar në spitalin rajonal të Prizrenit", ka thënë Gashi.

Ai ka theksuar se rasti i vrasjes së Astrit Deharit nuk do të duhej të keqpërdorej nga askush, më së paku nga Prokuroria Speciale, duke e shndërruar në betejë për opinion. "Prokuroria Speciale duket që e ka më të rëndësishme të japë prononcime krejtësisht të panevojshme për arsye që vetëm ata i dinë dhe është duke tentuar që ta luajë rolin e një prokurori të

mëhershëm i cili tentoi ta mbyllë rastin me pak se dy javë pas vrasjes së Astrit Deharit. Rasti i vrasjes së Astrit Deharit nuk do të duhet të keqpërdorej nga askush dhe më së paku nga Prokuroria Speciale duke e shndërruar në betejë për opinion, në vend që ta nxjerrin aktvendimin për zhvillim të hetimeve në drejtim të të gjeturave shkencore që japin vetëm një konkludim që Astrit Dehari është vrasë. Ligji thotë që palët janë të barabarta, por duket që Prokuroria këtë qëllimisht apo rastësisht nuk e aplikon", ka shkruar Gashi në logarinë e vet në "Facebook".

Kosova paralajmëron bashkëpunim me Zvicrën për pretendimet e Dick Martyt

PRISHINË, 12 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të martën se autoritetet e Kosovës do të bashkëpunojnë me shtetin e Zvicrës për të kuptuar më shumë për pretendimet e ish-raportuesit të Këshillit të Evropës, Dick Marty, se strukturat serbe të sigurisë kanë planifikuar vrasjen e tij.

Marty, ish-senator zviceran, ka hetuar krimet e supozuara të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë në periudhën janar 1998 - dhjetor 2000.

Kurti ka thënë se duhet të dihen shkaqet, rrethanat dhe informacionet e tjera për rastin, sepse ky rast nuk ka të bëjë vetëm me "Dick Marty, por edhe me Kosovën dhe shqiptarët". "Shteti dhe populli i Kosovës e kanë ditur gjithmonë se kush është Serbia, mirëpo unë shpresoj që Kuinti (Shtetet e Bashkuara, Franca,

Gjermania, Italia dhe Britania) në Beograd, Bashkimi Evropian në përgjithësi, ta ngrenë këtë çështje me presidentin atje dhe të gjitha organet shtetërore, sepse kjo është një akuzë e jashtëzakonshme, e cila i tejkalon përmasat individuale, e përfshin një shtet të tërë", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se "mënyra se si ka operuar Shërbimi Sekret serb në Evropën Perëndimore, edhe ndaj shqiptarëve, edhe ndaj kroatëve, është i njohur botërisht". "Duket që atë mënyrë e paskan planifikuar edhe ndaj Dick Martyt që të na fajësojnë neve".

Në një deklaratë për Shërbimin e Ballkanit të "Radios Evropa e Lirë", Agjencia serbe e Zbulimit - BIA tha se i ka dërguar letër Shërbimit Federal të Inteligjencës Zvicerane përmes së cilës i ka mohuar pretendimet për përfshirjen e shërbimeve serbe të sigurisë në "planifikimin e vrasjes së dikujt".



Pakoja e re ekonomike: Nga 100 euro për punëtorët e sektorit privat e publik, studentët dhe pensionistët

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar të martën se për muajin prill, pensionistëve, punëtorëve të sektorit privat e publik dhe studentëve do t'u ndahen nga 100 euro. Sipas tij, vlera totale për këtë ndihmë do të jetë rreth 100 milionë euro. "100 euro shtesë për pensionistët për muajin prill. Do të përfitojnë të gjithë ata që marrin pension bazik, pension kontributpagues, pension për aftësi të kufizuar, pension të veteranit e kështu me radhë. Me nga 100 euro, për herë të parë, do t'i mbështesim të gjithë punëtorët e sektorit privat, rreth 300 mijë punonjës. 100 euro shtesë do t'u ndahen edhe mbi 80 mijë zyrtarëve publikë. Me nga 100 euro do të mbështeten për herë të parë rreth 80 mijë studentëve të Republikës. Kësisoj, 100 milionë euro shtesë do të ndajmë në muajt në vijim mbi ndarjet e deritanishme të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, për mbështetjen e rreth 800 mijë qytetarëve", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se nga muaji korrik 2021 e deri më sot qeveria ka ndarë 300 milionë euro për mbi 740 mijë përfitues të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. "Rritjen e ekonomisë sonë (prej 10,53 % të Bruto Produktit Vendor) po e shpërndajmë për rritje të mirëqenies së qytetarëve duke e ndërtuar kështu shtetin social. Prandaj, së bashku me ministrin e Ministrisë së Financave, Transfereve dhe të Punës, Hekuran Murati, sot prezantuar masa të reja në kuadër të pakos", ka thënë ai.

Kryeministri ka treguar se në kuadër të këtyre masave të reja do të ketë dyfishim të mbështetjes për muajin prill për të gjitha familjet në asistencë sociale. "Kjo mbështetje do të jetë mbi rritjen e përhershme prej 30 %. Gjithashtu, 40 mijë pako ushqimore për shtresat më të cenueshme të shoqërisë tashmë kanë filluar të shpërndahen. Do ta vazhdojmë mbështetjen për ofrimin e shujtave përmes kuzhinave popullore. Kemi punuar për rritjen e pagës minimale dhe për heqjen e shkallës së parë tatimore në të ardhura personale. Nesër në mbledhjen e Qeverisë së Republikës do ta miratojmë projektligjin që ndërlihet me këtë dhe do ta hapim rrugën për rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto apo 250 euro neto, dhe për heqjen e tatimit për 250 euro pagë. Rreth 100 mijë punëtorë do të përfitojnë nga rritja e pagës minimale, kurse prej heqjes së shkallës së parë tatimore do të përfitojnë të gjithë punëtorët", ka thënë Kurti, duke u bërë thirrje



qytetarëve që të konsumojnë produkte vendore pasi, sipas tij, forcohet zinxhiri i ekonomisë dhe punësimit në Kosovë.

Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se vendimi i Qeverisë së Kosovës për ndarjen e shumës prej 100 eurosh për disa kategori reflekton varfërinë e politikave fiskale dhe sociale të qeverisë për ta mbrojtur standardin e jetës së familjeve. Sipas tij, kjo ndihmë nuk përfshinë mijëra të papunë dhe ata që merren me bujqësi. "Vendimi i sotëm reflekton varfërinë e politikave fiskale dhe sociale të qeverisë për ta mbrojtur standardin e jetës së familjeve. Kjo ndihmë e njëhershme prej 100 eurosh, sado e dobishme, nuk e zgjidh problemin e rritjes së çmimeve. Për më tepër, kjo

ndihmë nuk përfshinë mijëra të papunë dhe ata që merren me bujqësi. Duhet ndërmarrë masa afatgjatë, të cilat i kemi propozuar kur filloi të shfaqet kriza: Nuk është dashur të rritet çmimi i energjisë. Duhet të indeksohen përfitimet pensionale dhe sociale për normën e inflacionit të çmimeve të produkteve ushqimore bazike. Duhet të rriten subvencionet në bujqësi. Duhet të rritet paga minimale. Duhet konsideruar tërheqjen e një shume të kursimeve pensionale", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Sekretari i Partisë Demokratike të Kosovës, Berndard Nikaj, e ka cilësuar qeverinë Kurti të paafte për të qeverisur, pas vendimit të kësaj të fundit për ndarjen e

shtesave prej 100 eurove për punëtorët, studentët e pensionistët vetëm për muajin prill. Nikaj në një konferencë për medie tha se kryeministri çdo ditë po dëshmon se ai dhe ministrat e tij nuk kanë asnjë ide për ta zhvilluar vendin dhe për t'i adresuar nevojat dhe brengat e qytetarëve.

"Krejt çfarë po bën kryeministri Albin Kurti sot, është ajo që ai di ta bëjë më së miri, e që është populizmi. Pasi ua rriti çmimin e energjisë elektrike mbi 100 % qytetarëve të Kosovës dhe pasi nuk po arrin ta kontrollojë rritjen enorme të çmimeve të çdo produkti elementar të shportës familjare, qeveria e nisi sot ditën me një tentim për t'i mashtruar sërish qytetarët e Kosovës përmes

një lëmoshe as më shumë dhe as më pak se në vlerën 100 euro", ka thënë ai.

Duke e cilësuar këtë vendim si ndihmë sociale që do të jepet vetëm për muajin prill, Nikaj ka shtruar pyetjen se çfarë do të bëjnë qytetarët në muajin maj. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka kritikuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e 100 milionëve eurove nga pakoja e re financiare. Sipas tij, ky veprim 'ad hoc' i Qeverisë së Kosovës nuk zgjidh problemet e qytetarëve në një periudhë afatmesme ose afatgjatë, por që është një pako aty për aty. Ai madje ka thënë se ky vendim është si mungesë e politikave ekonomike dhe zhvillimore nga ana e ekzekutivit.

BSPK-ja dhe AKB-ja reagojnë pas premtimit të Kurtit për ndarjen e 100 eurove për punëtorët

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) kanë reaguar pasi kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka njoftuar se pensionistëve, punëtorëve të sektorit privat e publik dhe studentëve do t'u ndahen nga 100 euro për muajin prill. BSPK-ja ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që kjo të mos mbetet vetëm deklaratë që thuhet, por të realizohet në mënyrë që të rritet mirëqenia ekonomike dhe sociale e punëtorëve. "Mbështetja financiare është e mirë e çfarëdoqofshme qoftë ajo, po Bashkimi i Sindikatave të

Pavarura të Kosovës pret që hartimi i projektligjeve, miratimi dhe plotësim-ndryshimi i ligjeve të veçanta për jetën e të punësuarve të ecin dhe t'i rregullojnë fushat përkatëse asisoj që të mos ketë hapësirë e as nevojë të kërkohej që të ndodhë ndryshe", thuhet në reagimin e BSPK-së. Kjo sindikatë pret nga qeveria që brenda këtyre muajve t'ua plotësojnë edhe kërkesat e tjera si: Miratimi i Ligjit për Paga, nisja e zbatimit të Ligjit për Sigurimet Shëndetësore, plotësim-ndryshimi i Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe

nënshkrimi i marrëveshjes kolektive gjithëpërfshirëse. Edhe Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) përmes një reagimi ka komentuar zotimin e qeverisë Kurti për ndarjen e 100 eurove. Sipas AKB-së, kjo është pako sociale dhe jo pako për zhvillim ekonomik. "AKB-ja e vlerëson pakon sociale të mirë dhe të domosdoshme për këtë periudhë, pasi Kosovës po i mungon një pako zhvillimore si rezultat i mungesës të një Strategjie Kombëtare për Zhvillim Ekonomik. Prandaj paratë e taksapaguesve të qytetarëve duhet t'i kthehen përmes kësaj forme sociale, ku këtu përjashtohen qytetarët të

cilët nuk kanë asnjë të ardhur nga kategoritë e cekura të qeverisë", theksohet në reagimin e AKB-së. Më tutje thuhet se bizneset dhe investitorët kanë nevojë për më shumë reforma të politikave kyçe ekonomike që nxitin zhvillim, punësim, investime, eksport dhe prodhim. "Shpresojmë që Qeveria e Kosovës pakon e radhës do ta ketë fokusin në zhvillimin ekonomik dhe uljen e taksave të përkohshme për produktet bazike që qytetarët ta kalojnë më lehtë këtë periudhë të krizës ekonomike", është thënë në reagimin e AKB-së.

Çfarë mund të ndodhte nga një presidencë e mundshme e Marine Le Pen?

Nga Gideon RACHMAN
"Financial Times"

"Politikat që unë përfaqësoj janë politika që përfaqësohen nga Trump dhe Putin". Kështu u shpreh Marine Le Pen në vitin 2017. Pas 2 javësh, ajo mund të zgjidhet presidente e Francës. Le Pen, drejtuese e së djathtës ekstreme, ka kaluar në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, ku do të përballet sërish me presidentin Emmanuel Macron.

Raundi i parë i votimit e pozicionoi Le Pen 5 për qind pas Macron. Fakti që 57 për qind e votuesve francezë zgjedhën kandidatët e së majtës apo së djathtës ekstreme në raundin e parë – ndërsa partitë tradicionale të qendrës u poshtëruan sërish – shihet si një ogur i keq për një president centrist, siç është Macron. Sondazhi i parë lidhur me raundin e dytë, tregon se Macron mund ta mundë Le Pen me rezultatin 54 përkundrejt 46 për qind. Kjo mund do ta forcojë pikëpamjen se një fitore e Le Pen mbetet gati e pamundur. Por realiteti i sikletshëm është se e djathta ekstreme po arrin nivele konsensusi të paprecedenta në historinë e Francës së pas vitit 1945.

Dhe gjatë fushatës 2-javore mund të ndodhin shumë gjëra. Ndaj në vend se të hidhen poshtë shanset e Le Pen, është koha të mendohet seriozisht se çfarë do të nënkuptonte fitorja e saj e mundshme për Francën dhe më



gjerë. A është ajo ende një politikanë "e ekstremit të djathtë"? Apo një presidencë e Le Pen, mund të jetë më pak tronditëse për sistemin sesa e imagjinojnë shumë njerëz?

Fakti që Le Pen është kaq afër presidencës, është dëshmi e suksesit në "detoksifikimin" e imazhit të saj. Ajo u nda disa vite më parë me babanë e saj dhe themeluesin e partisë, Jean-Marie Le Pen, që kishte një histori të gjatë të racizmit. Në këto zgjedhje, Marine Le Pen ka bërë fushatë kryesisht mbi çështjet e kostos së jetesës.

Ajo ka hequr dorë nga politikat më të diskutueshme që sollën humbjen e saj në vitin 2017, si thirrja që Franca të largohet nga eurozona, apo edhe rivendosjen e dënimit me vdekje. Po ashtu, ajo e ka përdorur luftën në Ukrainë për t'u distancuar nga Vladimir Putin, duke pretenduar se ka "ndryshuar" pikëpamja e saj për liderin rus.

Por admirimi i saj i dikurshëm për

Putin dhe Donald Trump, është ende i dukshëm. Ashtu si ata, edhe Le Pen pretendon se përfaqëson popullin kundër elitës, dhe kombin kundër "globalistëve". Slogani i saj në këtë fushatë "Kthejuni francezëve vendin e tyre", i bën jehonë sloganit "Ta bëjmë Amerikën sërish të madhe" të Trump, dhe "Merrni sërish kontrollin e vendit tuaj" të mbështetësve së Brexit.

Programi i Le Pen përmban ende politika të së djathtës ekstreme. Premtimi i saj për të vendosur një ndalim të plotë të mbajtjes së shamive nga gratë myslimane në publik, është krejtësisht jo-liberal dhe do të ishte i paprecedentë në Evropë. Le Pen thotë se policia do të udhëzohej të vendoste gjoba për të gjitha gratë që mbajnë hijab.

Por marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe komuniteteve jo të bardha apo myslimane, tashmë të tensionuara, ka të ngjarë që të përkeqësohen më tej. E majta franceze, gjithmonë e prirur për

protesta, do të dilte në rrugë nëse do të fitonte Le Pen. Franca i ka ende të freskëta pasojat e protestave të "Jelek-verdhëve" në vitet 2018-2019, dhe mund të përballet sërish me trazira sociale.

Në anën tjetër të spektrit, një fitore e Le Pen mund të tronditë tregjet financiare, duke e forcuar ndjenjën e krizës. Një Francë shumë e polarizuar, do të shkaktoje pasoja negative në mbarë Evropën. Edhe për BE-në pasojat do të ishin të rënda, madje ekzistenciale.

Shtetarët francezë si Jean Monnet, Robert Schuman dhe Jacques Delors ishin dikur figurat kyçe të projektit evropian. Por Le Pen synon shkatërrimin e BE-së. Ajo premton të rivendosë përparësinë e ligjeve franceze ndaj ligjeve të BE-së, gjë që është e papajtueshme me anëtarësimin në unionin 27-vendesh.

Po ashtu ajo zotohet të reduktojë në mënyrë të njëanshme kontributet e Francës në buxhetin e BE-së.

Brenda Evropës, Le Pen ka kultivuar lidhje me "demokratët jo-liberalë" në Hungari dhe Poloni. Ajo nxitoi të uronte Victor Orban për fitoren e tij në fillim të këtij muaji, pavarësisht se ky i fundit akuzohet nga BE për shkeljen e sundimit të ligjit, shtypjen e lirisë së medias dhe korrupsion.

Në rastin më të mirë, Le Pen nuk shqetësohet për mëkatet e Orban. Në rastin më të keq, ajo e sheh atë si një model për Francën. Me Le Pen në krye të Francës, do dukej më i besueshëm pretendimi i Orban se nacionalizmi i tij jo-liberal përfaqëson të ardhmen e Evropës. Matteo Salvini në Itali – që ashtu si Le Pen ka si model Putinin dhe Trumpin – do të afrohej më pranë pushtetit. Reagimet në Bruksel dhe Berlin ndaj një fitoreje të Le Pen do të ishin të llahtarshme, të pasuara ndoshta nga negociatat. Në pamundësi për ta braktisur projektin e BE-së, partnerët e Francës do të synonin t'i bënin disi të pajtueshme me anëtarësimin në BE politikat ekstremiste të Le Pen.

Por ajo nuk është vetëm një armike e BE-së. Le Pen e ka quajtur NATO-n një "organizatë luftënxitëse", dhe është zotuar ta nxjerrë Francën nga struktura e saj komanduese. Po ashtu ajo kundërshton sanksionet ndaj Rusisë në fushën energjetike, me pretendimin se ato do të rrisnin koston e jetesës në Francë. Putini ka përjetuar së fundmi disa javë katastrofike. Por votuesit e Francës mund t'i ofrojnë ende një fare shprese.

Epoka e udhëheqësve autoritarë

Çfarë kanë të përbashkët liderë si Xi Jinping, Boris Xhonson dhe Princi saudit Muhamed Bin Salman? Më shumë se sa mund ta mendoni, shkruan Gideon Rahman, kolumnist i njohur i "The Financial Times", që ka punuar dikur edhe për "The Economist".

Ai i sheh të tri këta burra si një dëshmi të mbërritjes së "Epokës së udhëheqësve autoritarë", siç titullohet edhe libri i tij më i ri. Këta lloj udhëheqësish, paraqesin një kërcënim jo vetëm për mirëqenien e vendeve të tyre, por edhe për një rend botëror, në të cilin po luftohen gjithnjë e më shumë idetë liberale dhe kozmopolite.

Është e vështirë të kundërshtohet mendimi se që të tre ata, së bashku me liderë si presidenti turk Rexhep Taip Erdogan, kryeministri hungarez i sapozgjedhur për një mandat të ri Viktor Orban, dhe presidenti brazilian Zhair Bolsonaro, ndajnë disa tipare të përbashkëta.

Në shkallë të ndryshme, ata pretendojnë se flasin për njeriun e zakonshëm, ndërkohë që minojnë institucionet demokratike, ushqejnë nacionalizmin, dhe

kultivojnë një stil personal të të bërit politikë, madje në disa raste edhe një kult të drejtpërdrejtë të personalitetit.

Është e vërtetë që Boris Xhonson nuk është akuzuar se ka urdhëruar vrasjen e ndonjë kritiku, siç ka bërë Bin Salman, në rastin e gazetarit saudit Xhamal Kashoxhi. Por Rahman argumenton bindshëm se stili i liderit të fortë është një vazhdimësi, në të cilën afërsitë e eksponentëve të tij përforcohen ose dobësohen nga sistemi i veçantë politik në të cilin funksionon secili.

Është e habitshme të shihet se sa liderë bashkëkohorë i përshtaten "identikitit" të një lideri autoritar. Me Donald Trump dhe Narendra Modin, kryeministrin e Indisë, tre vendet më të populluara në botë u drejtuan deri vitin e kaluar nga liderë autoritarë.

Ata janë të pranishëm në Evropë (Xhonson, Orban dhe Vladimir Putin), në Afrikë (kryeministër i Etiopisë Abij Ahmed) dhe në Azi (Modi, Xi, dhe Rodrigo Duterte, presidenti i Filipineve). Lindja e Mesme ka Erdogan, Bin Salman dhe Benjamin Netanjahun, ish-

kryeministër i Izraelit.

Dy Amerikat kontribuojnë me Bolsonaron dhe presidentin e Meksikës Andres Obrador.

Lista përshin anëtarë të familjeve mbretërore, politikanë të zgjedhur dhe autokratë. Ata poshkaktojnë shumë dëme. Dëmi nuk është vetëm tek njerëzit që ata shtypin apo sistemet politike kombëtare që po gërryejnë nga brenda.

Liderët autoritarë po i shpërfillin institucionet globale, normat ndërkombëtare dhe bashkëpunimin shumëpalësh. Shumica prej tyre e shohin me dyshim tregtinë e lirë. Pak prej tyre janë të prirur të durojnë shumë shqetësime për të frenuar ndryshimet klimatike. Ata janë të prirur ndaj aventurizmit dhe agresionit në politikën e jashtme, siç po e dëshmon edhe pushtimin rus në Ukrainë.

Por lufta e vazhdueshme atje, e cila filloi pas shkrimit të librit, sugjeron gjithashtu edhe limitet e analizës së Rahman. Nën vëzhgimin e tij, liderët e fortë tregojnë pak solidaritet apo besnikëri diplomatike ndaj njëri-tjetrit. Disa kanë mbajtur anën e Putinit.



Të tjerët e kanë kundërshtuar, ndërsa të tjerë akoma po luajnë rolin e spektatorit. Identifikimi i dikujt si një udhëheqës i fortë, është vetëm një udhëzues i pjesshëm se si ka të ngjarë të sillat ai.

Argumenti më i fortë i Rahman nuk ka të bëjë me vetë udhëheqësit autoritarë, por me mendimet e dëshiruara të politikanëve dhe analistëve perëndimorë për ta (përfshirë me raste edhe vetë The Economist). Kur Putini pasoi në pushtet Boris Jelcin, ai u përshëndet si një njeri që mund ta stabilizonte

demokracinë ruse.

Edhe Erdogan u prit me optimizëm, si dikush që mund të pajtonte Islamin dhe demokracinë. Shpresohet që Abij t'i jepte fund ndarjeve etnike në Etiopi; që Bin Salman ta udhëhiqte në mënyrë të moderuar monarkinë saudite në shekullin XXI-të, e kështu me radhë. Demokracitë e vërteta të botës, mund të mos jenë fajtoresh për ngjitjen në krye të udhëheqësve autoritarë. Por ato nuk kanë qenë as shumë mendjempërta për ta shmangur këtë gjë. /

"The Economist" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Sot mësohen finalistët e Kupës



"Epoka e re"

PRISHTINË, 12 PRILL - Dy ndeshjet kthyesë të gjysmëfinale së Kupës së Kosovës në futboll do të zhvillohen sot (e mërkurë) nga ora 14:00. Në stadiumin "Zahir Pajaziti" Llapi e pret skuadrën e Prishtinës me synim që ta përmbysë rezultatin nga ndeshja e parë (2-1) e cila është zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Trajneri Tahir Batatina ka shprehur optimizëm se

skuadra e tij do të kualifikohet në finalen e madhe. "Mendoj se ndeshja më e rëndësishme është të mërkurën në 'Zahir Pajaziti'. Atje kemi publikë të zjarrtë dhe për herë të parë do të jetë stadiumi i mbushur. Do të jetë spektakël në tribuna dhe në fushë. Mendoj se do ta përmbysim rezultatin në stadiumin 'Zahir Pajaziti', ka thënë Batatina.

Siç dihet, skuadra e Llapit është fituese në fuqi e Kupës. Kualifikimin në finale synim e ka edhe skuadra e Prishtinës e cila do

të mundohet që fillimisht ta eliminojë Llapin e më pas të triumfojë në finale dhe në këtë mënyrë t' sigurojë daljen në garat evropiane, përkatësisht në Ligën e Evropës.

Në kampionat, Llapi dhe Prishtina pozicionohen në pozitat katër dhe pesë me 44, përkatësisht 38 pikë. Ndeshja tjetër është ajo në mes të Ramiz Sadikut dhe Dritës. Ndeshjen e parë që u zhvillua në javën e kaluar në Gjilan, Drita e fitoi me rezultat 3-0 dhe është shumë afër kalimit në finale.

SHKURT

Gauthier Mankenda, 'ylli i javës' në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës, së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ndarjen e çmimit "ylli i javës". Ky çmim për xhiron e 28 në BKT Superligë i ka takuar futbollistit të Prishtinës, Gauthier Mankenda. Sulmuesi anësor i bardhekaltërve pati paraqitje të shkëlqyeshme në fitoren tejet të rëndësishme të skuadrës së tij kundër Malishevës, me rezultat 3:2. Ai përveçse shënoi golin e parë në ndeshje, në vazhdimësi u tregua i rrezikshëm për portën rivale dhe ishte mjaft kreativ në lojë. Për Mankendan kjo është hera e parë që fiton çmimin "ylli i javës" në këtë edicion të garave. Pas fitores ndaj Malishevës skuadra e Prishtinës është stabilizuar në renditje në pozitën e pestë, me 38 pikë. Çmimin "ylli i javës" për futbollistin e FC Prishtina e dorëzoi Besart Zogjani, line menaxher në BKT.

Tare, sherr me Sarrin për Strakoshën

Thomas Strakosha mbetet ende pezull. Rinovimi me portierin shqiptar është më shumë një dëshirë e klubit të Lazios ose, më saktë, e drejtorit sportiv Igli Tare. Lazio do të ketë shumë ndryshime në verë dhe duke ditur se sa duhet investuar, nuk do të dëshiron të shpenzonte shumë edhe për një portier. Sidomos që tashmë ka një të besueshëm, por duket se trajneri Sarri nuk e do. Nga ana tjetër, Strakosha, i cili u merrz sezonin e kaluar pasi vendin e titullarit ia mori Reina, ka rritur kërkesat e tij. Duke ditur se në mes është Igli Tare, marrëveshja mes palëve mund të jetë më lehtë për t'u gjetur.

Rrahmani do të shpërblehet nga Napoli

Futbollisti i Kosovës, Amir Rrahmani, ka shkëlqyer me fanellën e Napolit në këtë edicion. Klubi italian po planifikon ta shpërblejë mbrojtësin duke ia vazhduar kontratën. Rrahmani ka kontratë me napolitanët deri në vitin 2024, por "Corriere dello Sport" raporton se klubi nga Seria A e ka bërë gati një kontratë afatgjatë, të cilën do t'ia prezantojë lojtarit. Napoli po planifikon të bëjë revolucion në ekip për sezonin e ardhshëm, por edhe t'i "blindojë" lojtarët që i konsideron të rëndësishëm. E njëri prej tyre është edhe ish-futbollisti i Dinamo Zagrebit e Veronës, i cili, së bashku me Kalidou Koulibaly, e përbën njëri prej mbrojtjeve më të mira në Serinë A. Krahas Rrahmanit, Napoli synon ta vazhdojë kontratën edhe me qendërmbrojtësin tjetër, Juan Jesus dhe me portierin Meret. Ditë më parë u spekulua se interesim për Rrahmanin ka shfaqur gjiganti britanik Manchester United.



Mendim Ujupaj fiton medaljen e artë dhe të argjendtë

PRISHTINË, 12 PRILL - Mendim Ujupaj e ka lartësuar flamurin e Kosovës në turneun ndërkombëtar "Super Match 2022". Ky sport ka të bëjë për mundje të krahut, derisa sportisti ynë ka shkëlqyer në turneun e

mbajtur në Brescia të Italisë. Ujupaj ka fituar medaljen e artë në garimin me dorë të djathtë, ndërsa me të majtën ka marrë atë të argjendtë. "Garuesi ynë i mundjes së krahut, Mendim Ujupaj, fitoi dy medalje në turneun

ndërkombëtar Super Match 2022, të mbajtur gjatë fundjavës në Brescia të Italisë. Medaljen e artë e fitoi me dorën e djathtë, kategoria 75 kg, ku në konkurrencë kishte 39 garues, ndërsa të argjendtën e fitoi me dorën e majtë (33

garues). 25-vjeçari Ujupaj jeton dhe vepron në Zvicër, ndërsa ka vendosur ta përfaqësojë Kosovën pas formimit të Federatës Mundje Krah të Kosovës vitin e kaluar", thuhet në njoftimin e Komitetit Olimpik të Kosovës.

Më 23 korrik përballen Usyku - Joshua

Londër, 12 prill - Revanshi i peshës së rëndë në boks mes boksierit ukrainas Oleksandr Usyk dhe atij britanik Anthony Joshua do të zhvillohet më 23 korrik. Sipas ESPN, të dyja palët kanë konfirmuar datën, duke

kërkuar tre muaj kohë për t'u përgatitur për këtë sfidë. Dueli është i vlefshëm për titujt kampionë që mbahen nga ukrainasi. Për t'u konfirmuar është vetëm vendi i sfidës, me Arabinë Saudite që duket në "pole"

për të organizuar këtë duel, ndërsa Londra duket më pas. Oferta financiare që ka mbërritur nga Lindja e Mesme është më e kënaqshme, ndaj mendohet se revanshi do të zhvillohet në shkretëtirë. Në përballjen

e parë, zhvilluar në shtatorin e vitit të kaluar, Usyk (19 fitore, 0 humbje) fitoi me vendim unanimit të gjyqtarëve, duke i rrëmbyer Joshuas (24 fitore, 2 humbje) titujt kampionë bote. Revanshi është shtyrë disa muaj për



shkak se Usyk ndodhej në vendlindje për ta mbrojtur Ukrainën nga sulmi i Rusisë.

Sonte mësohen edhe dy gjysmëfinalistë

Atletico Madridi do të përpiqet ta përmbysë rezultatin e ndeshjes së parë ndaj Manchester Cityt prej një goli dhe të kualifikohet në gjysmëfinale. Gjysmëfinalisti tjetër pritet të jetë Liverpooli, pasi ka rezultat të favorshëm nga ndeshja e parë ndaj Benficës (1-3)

"Epoka e re"

MADRID, 12 PRILL - Atletico Madridi do të kërkojë ta përmbysë epërsinë prej një goli të Manchester Cityt nga ndeshja e parë (1-0). Ndeshja kthyesë mes këtyre dy skuadrave zhvillohet sonte (e mërkurë) në "Wanda Metropolitano", ku edhe do të vendoset skuadra që kualifikohet në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Një gol i Kevin De Bruynes vendosi fitoren e skuadrës së Pep Guardiols në ndeshjen e parë, derisa fituesi i kësaj ndeshje pritet të përballlet me fituesin e ndeshjes Real Madrid - Chelsea. Pas humbjes nga City, kampionët në fuqi të La Ligës pësuan humbje edhe në kampionat nga Mallorca. Golin e fitores e shënoi Vedat Muriqi. Atletico nuk ka gjasa që ta mbrojë titullin në Spanjë, derisa Manchester City është në garë për të bërë një gjë të tillë në Angli dhe në fundjavë luajti baras me Liverpoolin e vendit të dytë (2-2). Trajneri i Atletico, Diego



Simeone, do ta mirëpresë Yannick Carrascon përsëri në fushë pasi pezullimi e mbajti jashtë humbjes në ndeshjen e parë. Mesfushori Hector Herrera mbetet jashtë fushës së bashku me mbrojtësin kryesor Jose Gimenez. Në anën tjetër, City do të jetë pa Palmerin dhe Diasin. Kyle Walker është rikthyer, por nuk dihet ende se a do të jetë startues, pasi Nathan Ake ka bërë paraqitje të mirë. Ndeshja e dytë që zhvillohet sonte është në mes të Liverpoolit dhe

Benficës. Klubi anglez me një këmbë e ka siguruar kalimin në gjysmëfinale, pasi e ka fituar ndeshjen e parë në Portugali me rezultat 1-3.

FORMACIONET E MUNDSHME:
Atletico Madrid: Oblak; Saviq, Felipe, Reinildo; Vrsaljko, Llorente, Koke, Lemar, Lodi; Griezmann, Felix.
Manchester City: Ederson; Walker, Stones, Laporte, Ake; Gundogan, Rodri, De Bruyne; Mahrez, Foden, Sterling.

Van Gaali flet për sëmundjen me kancer: Jam i emocionuar, kam lot në sy

AMSTERDAM, 12 PRILL - Trajneri holandez Louis van Gaal, i cili javën e kaluar njoftoi se vuante nga kanceri i prostatës, siguroi të hënën për gjendjen e tij shëndetësore, duke thënë në veçanti se seancat e tij të kimioterapisë, si dhe operacioni, kanë qenë të suksesshme. "Kam bërë 25 seanca kimioterapie. Pastaj më duhej të prisja pesë ose gjashtë muaj për të parë nëse funksiononte. Ishte çdo gjë mirë", ka thënë Van Gaal, cituar nga agjencia holandeze e lajmeve "ANP".

Van Gaal zbuloi të dielën e kaluar se vuante nga kanceri i prostatës që nga viti 2020, ndërsa siguroi se sëmundja nuk do ta pengonte të



shkonte në Katar për Kupën e Botës (21 nëntor-18 dhjetor). "Këto seanca kimioterapie ishin lënë pas meje përpara nënshkrimit të kontratës me KNVB (Federata Holandeze) në gusht", ka deklaruar Van Gaal, i pyetur nga televizioni publik

'NOS' të hënën në mbrëmje, në premierën e filmit të tij "Louis në Amsterdam".

Njoftimi për sëmundjen e ish-trajnerit të Ajax Amsterdimit, Barcelonës, Bayern Munchenit dhe Manchester Unitedit kishte shkaktuar emocione të mëdha në mbarë botën e futbollit. "Nuk e kisha menduar kurrë se do të kishte pasur një ndikim të tillë në botë", ka deklaruar për 'NOS' tekniku, i cili duhej t'i nënshtronte një operacioni në shkurt. "Më duket e pabesueshme. Unë emocionohem për këtë. Kam lot në sytë e mi. Gjithashtu, ka energji që kaq shumë njerëz kujdesen për mua", ka deklaruar ai për të gjitha shenjat e mbështetjes që ka marrë.

SHKURT

Benzema është favorit për 'Topin e Artë'

Për më shumë se një dekadë "Topi i Artë" u kthye në një dialog të vazhdueshëm ndërmjet Leo Messit dhe Cristiano Ronaldos. Ky epilog pritet të përfundojë këtu, duke parë edhe rendimentin shumë të dobët të një prej lojtarëve më të mirë të gjithë kohëve. Këtë vit, pavarësisht se u eliminuan nga Liga e Kampionëve, në lojë është Botërori, një turne që pritet të jetë përcaktues për ta shpallur fituesin e "Topit të Artë". Pavarësisht prej këtij fakti, "L'Equipe" e ka një favorit kryesor: Karim Benzema. E përditshmja franceze në faqen e parë "kurorëzon" Benzeman: Në apel për të artën", shkruan "L'Equipe". Në fakt, edhe duke iu referuar shifrave, të paktën deri më tani, askush nuk ka bërë më shumë se Benzema, mbi të gjitha pas dy "tripletave" që realizoi së fundmi në Ligën e Kampionëve kundër PSG-së dhe Chelseas.

Enrique për Ronaldon: Nuk më pëlqen, mendon se është Zoti

Kritikat mbi Cristiano Ronaldon janë shtuar ndjeshëm pas skenës që ai hodhi në tokë telefonin e një fëmije të sëmurë me autizëm. Ish-futbollisti i Liverpoolit, Jose Enrique, thotë se Ronaldo mendon se mund të bëjë gjithçka pa pasur pasojë, ndërsa shtoi se luzitanit i duket vetja Zot. "E kam thënë gjithnjë se Ronaldo nuk më pëlqen. Mendon se është Zoti dhe mund të bëjë gjithçka pa pasur pasojë. Nuk po them se ai nuk është një nga lojtarët më të mirë në botë, por si person nuk më pëlqen aspak", ka thënë Enrique.

Lewandowski, afër marrëveshjes me Barcelonën

Pas tetë vjetëve me fanellën e Bayern Munchenit, duket se aventura e Robert Lewandowskit me klubin bavarez ka ardhur në fund. Sipas medieve polake, sulmuesi ka vendosur të mos rinovojë kontratën me gjermanët dhe të largohet në verë. Madje, 33-vjeçari ka identifikuar edhe klubin e radhës me të cilin do të kërkojë ta vazhdojë "gjuetinë" e trofeve. Barcelona ka "joshur" polakun dhe nga sezoni i ardhshëm Lewandowski pritet të jetë nën urdhrat e trajnerit Xavi Hernandez, ku sigurisht objektivi do të jetë të triumfojë në La Liga dhe Ligën e Kampionëve. Mesa duket, Erling Haaland kushton shumë dhe blaugranët janë të lumtur me Lewandowskin, i cili, pavarësisht moshës, ka treguar se mbetet një nga "nuhatësit" më të mirë në Evropë teksa në 38 paraqitje me Bayernin në të gjitha kompeticionet, ka realizuar plot 44 gola.

Dortmundi në garë për Hazardin

Përvoja e Eden Hazardit me fanellën e Real Madridit nuk ka shkuar ashtu siç lojtari belg dhe drejtuesit kishin menduar, dhe me shumë gjasa ish-lojtari i Chelseas do t'i thotë lamtumirë "Santiago Bernabeut" në fund të sezonit. Lëndimet dhe një paraqitje jo në nivel të lartë kanë bërë që marrëdhënia mes palëve të mos jetë siç duhet, ndërsa Hazard tashmë po kërkon ringitjen në nivele të larta dhe për këtë po shikon mundësinë e një kampionati tjetër. Sipas "Cadena Ser", raportohet se në fund të sezonit belgu do t'i bëjë valixhet gati për t'u larguar nga Spanja, teksa për momentin duket se në "pole-position" për ish-futbollistin e Lille është Borussia Dortmundi.

Lakersat marrin vendimin ekstrem pas dështimit në kampionat

Frank Vogel, trajneri që ua solli lakersave titullin kampion në vitin 2020 në mes të pandemisë, është shkarkuar nga detyra, pas zhgënjimit të këtij sezoni. Ekipi kalifornian nuk arriti të

kualifikohej në fazën "play-off" dhe largimi i trajnerit është masa e parë e marrë nga klubi legjendar i NBA-së. Lajmin e konfirmoi klubi përmes menaxherit Rob Pelinka: "Patëm

një takim të hapur me trajnerin, ku diskutuam për këtë çështje. Ai është pjesë e historisë së ekipit tonë. Nuk duam ta fajësojmë për këtë dështim, por menduam se është momenti për të nisur një

cikël të ri, me një trajner të ri". Këtë vit lakersat konsideroheshin favoritë për titullin, por dëmtimet bënë që ekipi ta vuajë shpesh mungesën e lojtarëve lider. Këtë sezon trajneri Vogel ka hedhur në

fushë në 41 ndeshje një formacion ndryshe, kushtëzuar nga mungesat. Kandidatë për ta zëvendësuar janë Quin Snyder (Utah Jazz), Nick Nurse (Toronto) e Doc Rivers.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022 të datës 15 shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

K O N K U R S

I. Zyrtar Ligjor 2, pesë (5) vende pune
Prokuroria Themelore Prishtinë, dy (2) pozita
Prokuroria Themelore Gjakovë, dy (2) pozita
Prokuroria Themelore Mitrovicë, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 004
Emri pozitës:	Zyrtar Ligjor 2
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Profesional
Kodi punës:	LJ/060
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave:	Pesë (5) pozita
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuase:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi :	Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë

Qëllimi i vendit të punës:

Ndërmerr të gjitha veprimet konkrete dhe iniciativa profesionale për kryerjen sa më efektive dhe kualitative të punëve të Prokurorit duke i ofruar mbështetje profesionale juridike në hartimin e akteve, shkresave dhe daktilografimin e tyre si dhe mbajtjen e evidencave për lëndët në proces dhe të kryera nga Prokurori e në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e Shkrimores së Prokurorisë dhe Udhëheqësin e Administratës.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Ndihmon në mënyrë profesionale Prokurorin me daktilografim profesional të akteve që i nxjerrë prokurori lidhur me lëndët konkrete të besuara për ndërmarrjen e veprimeve akuzuese nga prokurori;
Pranon lëndët e ndara për prokurorin me të cilin punon, evidentimin e tyre në mënyrë elektronike dërgimin e lëndëve me shkresat përcjellëse në shkrimore, mbajtjen e evidencës për lëndët në proces dhe lëndët e kryera, raporton për punën e vet të Udhëheqësi i Administratës;
Merr pjesë në procesin e dëgjimit të palëve duke e mbajtur procesverbalin e marrjes në pyetje, ruan konfidencialitetin e lëndës dhe palëve;
Kryen të gjitha punët përgatitore për praninë e palëve para prokurorit me dërgesën e ftesave dhe pranimin e konfirmimeve nga dorëzuesit e shkresave;
Gjithnjë kujdeset për informimin e Prokurorit lidhur me praninë e tij në gjykime, duke mos e lënë anash informimin lidhur me shkresat e ndryshme apo (corpora deliktet) që ndërliken me lëndën gjyqësore;
Përgjegjës për kryerjen e punës në mënyrë sa më profesionale, duke u kujdesur që gjatë punës së besuar të ketë sa më pak lëshime;
Për punën e vet i përgjigjet udhëheqësit të administratës, ndërsa për punën e kryer me prokurorin lidhur me lëndët mbanë edhe përgjegjësi tek prokurori i çështjes, andaj kërkohet një sy çelësi dhe vëmendje e veçantë;
I obliguar të respektojë Kodin e Etikës Profesionale të stafit mbështetës dhe Kodin e Shërbimit Civil;
Kryen edhe punë tjera që ndërliken me pozitën e tij/saj duke i zëvendësuar kolegët tjerë në punë.

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi juridik dhe administratë publike;
Njohuri të mirë të gjuhës shqipe, dhe/ose serbe e dëshirueshme, në të shprehur me gojë dhe me shkrim duke përfshirë aftësi të zhvilluara në hartimin e dokumenteve;
Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point, etj.) dhe internetin;
Shkathtësi për shqyrtimin e lëndëve, aktakuzave dhe shkresave tjera të nevojshme;
I/E gatshëm/e të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me të;
Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik.

Përvoja e punës:

Një (1) vit përvojë pune profesionale.

II. Zyrtar për Transport 3, dy (2) vende pune

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, një (1) pozitë
Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 005
Emri pozitës:	Zyrtar për Transport 3
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Administrativ
Kodi punës:	AD/1110
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave:	Dy (2) pozitë
Koeficienti:	Pesë pikë pesë (5.5)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna provuase:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve të transportit për prokurorë dhe stafin e Institucionit.
Kujdeset për aktivitetet e drejtpërdrejta lidhura transportin në institucion dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Kryen punën e vozitjes së prokurorëve dhe stafit në bazë të orarit dhe caktimeve zyrtare, në nivel të prokurorisë;
Mirëmban automjetin me të cilin kryen detyrat e punës apo me të cilin është i ngarkuar;
Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e transportit dhe siguron mirëmbajtjen e punëve lidhur me shërbimet e transportit;
Është përgjegjës për sigurimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve transportuese të institucionit;
Mban të dhënat për përdorimin, sevisimin e automjeteve dhe përgatit dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre;
Kujdeset që automjetet e institucionit të përdorën në mënyrë sa më racionale;
Ofron shërbime të transportit sipas nevojave;
Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të duhura profesionale për kryerjen e detyrës së vozitësit;
Shkathtësi për të caktuar dhe vlerësuar punën sipas rëndësisë dhe prioritetëve;
I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
Të ketë gatishmëri për kryerjen e punëve nën presion.
Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Shkolla e Mesme, Patentë Shoferi Kategorija "B".

Përvoja e Punës:

Së paku 3 vite përvojë pune.

III. Zyrtar për Distribuimin e Dokumenteve 1

Prokuroria Themelore Pejë, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 006
Emri pozitës:	Zyrtar për Distribuimin e Dokumenteve 1
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Administrativ
Kodi punës:	PBS/1570
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Pesë (5)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuase:	Dymbëdhjetë (12) muaj
